

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani kryetar i kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Shqipe Qerimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit, E.M., nga ..., për shkak të veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 2 të KPK, dhe veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtrri, P.nr.186/2016, të datës 27.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 31.01.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e pjesërishtëm të ankesës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, **ndryshohet**, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtrri, P.nr.186/2016, të datës 27.10.2016, përkitazi me vendimin për dënimin, ashtu që kolegji i kësaj gjykate të akuzuarit E.M., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPK, i shqipton dënimin me gjobë në shumën prej 600 (gjashtëqind) €, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-dega në Vushtrri, P.nr.186/2016, të datës 27.10.2016, është shpallur fajtor i akuzuari, E.M., për shkak të veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 2 të KPK, dhe veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 300 (treqind) €, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë komforë nenit 46 par 3 të KPK, do të zëvendësohet në dënimin me burgim, në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 (njëzetë) €, sa i përket pikës I të dispozitivit të aktakuzës.

Në kuptim të nenit 60 të KPK, i shqiptohet dënimi plotësues, marrja e revoles të markës “PAK.P.A.K-Walther me nr.serik B-54579440”.

Është obliguar i akuzuari që ti paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 20 (njëzetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Sa i përket pikës së I të dispozitivit të aktakuzës, komfor nenit 2 dhe 3 par 1,2,5, të Ligjit për Amnisti, Nr.04/L-2009, me aktvendim është hedhur aktakuza e Prokurorisë Publike të Qarkut në Mitrovicë, PP.nr.112/2011, të dt.17.10.2011, dhe është pushuar procedura penale kundër të akuzuarit për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, në kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par 2 të KPK, për shkak që vepra penale është përfshirë me amnisti.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë Prokuroria Themelore në Mitrovicë, për shkak të vendimit për dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet, dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim efektiv

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.1558/2016, të datës 13.12.2016, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e prokurorisë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar, të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet dënimi me burgim efektiv.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, e duke vlerësuar të gjitha shkresat e lëndës sipas detyrës zyrtare, ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, nuk është e bazuar.

Me qenë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 të KPPK, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar nëse i njëjti është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje të dispozitave të procedurës, të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe shkeljet e ligjit penal në dëm të akuzuarit, për të cilat kjo gjykatë kujdeset kryesisht sipas detyrës zyrtare.

Sipas ankesës se Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë ankimohet për shkak vendimit për dënimin, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë gjendjen faktike e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, mirëpo me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar vetëm rrethanat lehtësuese sikurse janë, se i akuzuari vullnetarisht e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka pasur qëndrim korrekt në gjykatë, se ka kaluar kohë relativisht e gjatë prej kryerjes së veprës penale e gjerë në vendosje, ndërsa si rrethana rënduese ka marrë se i njëjti ka shti tri herë në ajër përmes dritares së automjetit, me qëllim për të frikësuar të dëmtuarin Shemsi Ibra, andaj, në prani të këtyre rrethanave vendimi për dënimin nuk është proporcional me peshën e veprës penale, sepse jo vetëm që

ka patur për qëllim për ta frikësuar të dëmtuarin, por përdorimi i armës ka mundur të jetë fatal për jetën e tij, pasi që ka qenë i dehur dhe duke u kthyer nga dasma në orët e vona të natës.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar nga prokuroria, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, në kuptim të nenit 73 të KPK, sikurse janë rrethanat lehtësuese, se i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, se ka patur qëndrim korrekt në gjykatë, se është penduar për veprën penale të kryer, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar se përdorimi i armës është bërë në mënyrë të paautorizuar, se e njëjta është përdorur me qëllim frikësimit, pasi që i dëmtuari ka qenë në gjendje të dehur dhe duke u kthyer nga dasma në orët e vona të natës, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se me dënimin e shqiptuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 41 të KPK, që të parandaloj kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëj kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Si u cekë edhe më lart u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi komform nenit 403 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.1526/2016 të datës 31.01.2017

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetari i kolegjit
Ferit Osmani

Shqipe Qerimi